



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 05 Prot

Tiranë më, 06 / 03 / 2020

VENDIM

“Për konstituimin e Komisionit Institucional Zgjedhor të Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05. 1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 08, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, urdhrin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 130 Prot, datë 02.03.2020, vendimin e Senatit Akademik të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 5, datë 05.03.2020 dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.03.2020:

VENDOSI

1. Konstituimin e Komisionit Institucional Zgjedhor të Akademisë së Studimeve Albanologjike.
2. Zgjedhjen e z. Hasan Bello, si Kryetar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1. Hasan Bello 
2. Ervin Kaçiu 
3. Erjena Lamaj 
4. Ergys Hasa 
5. Anila Shorri 

SEKRETARE

Albana Mema

